



**PLANI PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË  
MËSIMDHËNËSVE  
2020-21**

Ky dokument është përgatitur nga Zyra e Prorektorit për Mësim-  
dhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore

**Prof. Ass. Dr. Shemsi Morina**

**Prill, 2020**

Prizren 1

## **PËRMBAJTJA**

Hyrje.....	3
Konstituimi i Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie.....	4
Ngritja e kapaciteteve të Qendrës .....	4
Prioritetet për trajnime .....	5
Kategoritë e zhvillimit profesional për stafin akademik .....	5
Koha e realizimit të trajnimeve gjatë vitit 2020/2021.....	6

## **HYRJE**

Qëllimi i këtij dokumenti është hartimi i një plani për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të “Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, duke u bazuar në praktikën më të mirë. Universiteti ka staf mjaft të mirë të përgatitur profesionalisht dhe me përvojë, por pa dyshim që nevoja për përsosmërinë në mësimitdhënie gjithmonë egziston, marr parasysh ndryshimet e shpejta në të gjitha fushat e në veçanti në fushën e arsimit. Për këtë arsye duke u nisur orientimet strategjike që ka universiteti për rritjen e performancës së stafit të saj, jemi të përkushtuar që të kontribuojmë sa më shumë në zhvillimin dhe avansimin e stafit me qëllim që të jemi në hap me ndryshimet në shkencë . Po ashtu nga rezultatet e vlerësimit të vitit të fundit por edhe të viteve të kaluara, kemi arritur në përfundim që ka nevojë për hartimin e një plani të mirëfilltë për zhvillimin profesional të stafit. Në këtë kontekst, me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, më: 12.03.2020 është themeluar edhe Qendra për Përsosmëri në Mësimitdhënie në Universitetin “Ukshin Hoti”. Qëllimi i kësaj qendre është avansimi profesional i stafit dhe sigurimi i përsosmërisë në mësimitdhënie, përmes promovimit të kulturës akademike dhe duke ofruar mundësi për zhvillim profesional të profesorëve e asistentëve aktual, dhe profesorëve dhe asistentëve të rinjë në Universitet. Themelimi i kësaj Qendre është edhe objektiv i vendosur në Planin Strategjik 2020-2020 të Universitetit tonë, i cili dokument është udhërrëfyese ynë tani e tutje, ku si prioritet mbi prioritete është Sigurimi i Cilësisë në Mësimitdhënie dhe Mësimnxënie.

Universiteti do të vendos bazë të mirëfillta dhe të qëndrueshme për zhvillimin profesional të stafit akademik. Për këtë arsye do të fokusohet në konsituimin e Qendrës për Përsosmëri në Mësimitdhënie me organet drejtuese. Pastaj vjen faza e identifikimit dhe emërimit të trajnerëve. Në vazhdim do të bëhet trajnimi i trajnerëve dhe në këtë drejtim synojmë të hartojmë një projekt konkret i cili presim që të gjenë mbështetje në kuadër të programeve ndërkombëtare. Kështu do të vendosen bazat e qëndrueshme

për zhvillimin afatëgjatë të stafit të Universitetit. Derisa Qendra të krijoj kapacitete, Universiteti do të kontrakttojë operatorë të jashtëm që do të organizojnë trajnime për stafit e Universitetit.

## **KONSTITUIMI I QENDRËS PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE**

### **Caktimi i Strukturave të Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie.**

1. Emërimi i Bordit Këshillëdhënës;
2. Kryesuesi i këshillit të trajnerëve (njëkohësisht koordinator i qendrës);
3. Përcaktimi i Vizionit dhe Misionit si dhe dokumenteve për punën e Qendrës;
4. Emërimi i Këshillit të Trajnerëve (Lista e trajnerëve në bazë të fushave);

Konstituimi i Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie do të bëhet gjatë periudhës:

**Maj – Korrik 2020.**

## **NGRITJA E KAPACITETEVE TË QENDRËS**

Pas konsituimit të qendrës me të gjitha organet dhe listën e trajnerëve, duhet që të krijohen kapacitetet për punë në arritjen e misionit të Qendrës. Në këtë kuadër do të organizohen trajnime për trajnerët e kësaj Qendre.

Në fazën e parë synohen të trajnohen deri në 10 (dhjetë) trajnerë, të cilët do të jenë në gjendje të organizojnë trajnime në fushat e caktuara për stafin tjetër akademik të Universitetit.

Kjo synohet të realizohet gjatë periudhës:

**Shtator 2020- Janar 2021.**

Gjatë kësaj periudhe të të hartohet edhe një projektpropozim për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë të kësaj Qendre, duke identifikuar partnerët potencial brenda dhe jashtë vendit.

Qendra do të ketë kapacitete që të ofrojë trajnimet e para gjatë muajit:

**Shkurt 2021.**

## **PRIORITETET PËR TRAJNIME**

Nga vlerësimi i fundit i mësimdhënësve, kemi identifikuar tre prioritetet kryesore të trajnimit siç përcaktohen nga secili fakultet por edhe me rekomandim të Komsionit Qendror për Sigurimin e Cilësisë:

- 1. Mësimdhënie dhe mësimnxënie;**
- 2. Lidërshipi dhe aftësitë drejtuese;**
- 3. Hulumtimi;**
- 4. zhvillimi i karrierës;**
- 5. Aftësimi i gjuhës.**

## **KATEGORITË E ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR STAFIN AKADEMIK**

Kategoria	Përshkrimi
Mësimdhënia dhe Mësimnxënia:	Hartimi i kurrikulës dhe Syllabusit, vlerësimi i studentëve, motivimi i studentëve, përdorimi i metodave të reja, përdorimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor, dhe mësimi i bazuar në raste apo problem.
Lidërshipi:	Ofrimi i trajnimeve në komunikim ndërnjerëzor, menaxhimin e kohës, puna në grupe, zgjidhja e problemeve dhe komunikim ndërkulturor.
Hulumtimet:	Trajnime për përmirësimin e aftësive kërkimore,

	shkrimi i projekt propozimeve për gjetjen e financimit, identifikimi i revistave kredibile me indeksim dhe impakt factor, modelimi, analizimi i të dhënave dhe shkrimi i punimeve shkencore.
Zhvillimi i Karrierës:	Trajnime për planifikimin e zhvillimit të karrierës
Mësimi i gjuhëve të huaja:	Kurse për mësimin e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera.
Trajnime tjera:	Organizimi i mësimin online, përdorimi i sistemit antiplagjiat, etj.

Të gjithë 79 anëtarët e bashkësisë akademike të Universitetit “Ukshin Hoti” përmes instrumenteve të sigurimit të cilësisë, pyetësorëve janë vlerësuar nga studentët, dekanët, vetëvlerësimin dhe në fund janë analuar të dhënat nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë në nivel fakulteti të cilat ka shqyruar edhe ka dhënë rekomandimet e nevojshme. Mbi këtë bazë është hartuar ky dokument.

### **KOHA E REALIZIMIT TË TRAJNIMEVE 2020/2021**

Trajnimet	Koha e realizimit	Numri i pjesmarrësve të synuar
Mësimdhënia dhe Mësimnxënia	Shtator 2020-Janar 2021	79
Lidershipi:	Tetor 2020	79
Hulumtimet:	Nentor 2020	79
Zhvillimi i Karrierës:	Dhjetor 2020	79
Mësimi i gjuhëve të huaja:	Shtator 2020–Janar 2021	50
Trajnime tjera:	Korrik – Dhjetor 2020	79

